



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1050 Prot.

Tiranë, më datë 31.08.2022

VENDIM
Nr. 438, datë 31.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe Vendim Nr. 60, datë 29.1.2020 “Për Deklarimin Pasuri Kulturore “Ansambël Historik Urban”, Zonës Mbrojtëse Të Tij, Dhe Zonës Arkeologjike “B”, Të Fshatit Voskopojë Dhe Miratimin E Planit Për Ruajtjen, Mbrojtjen Dhe Administrimin E Tyre”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Njësi Akomodimi 1-2 kate+Podrum”, Voskopojë, Brenda Kufirit Ansambël Historik Urban, me aplikues Aleko Papakozma dhe zhvillues Zguro Sh.p.k;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara prej tij të dokumentacionit teknik pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

